

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Simmica, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit B.L., për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par.1 i KPRK-së, duke vendosur, sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik P.nr.201/16 datë 03.04.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAI.nr.562/2017 të datës 05.09.2017, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datë 11.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.L., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik P.nr.201/16 të datës 03.04.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAI.nr.562/2017 të datës 05.09.2017.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, me aktgjykimin, P.nr.201/16, të datës 03.04.2017, të dënuarin B.L., e ka shpallur fajtor, për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par. 1 i KPRK-së dhe i ka shqiptuar, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kurse në dënimin e shqiptuar i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 24.06.2016 deri në datën 20.09.2016. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguajë shumën prej 50 € dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAI.nr.562/2017 të datës 05.09.2017, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit B.L., av. Y.H., duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik P.nr. 201/2016 të datës 03.04.2017, vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që të dënuarin B.L., për veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par.1 të KPRK-së, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj. Aktgjykimi i ankimuar në pjesët tjera ka mbetur i pa prekur.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Y.H., nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dëm të dënuarit nga neni 190 par.1 të KPRK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën dhe t'i anulojë, aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KMLP.II.nr.155/2017, të datës 11.09.2017, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënëpar.1.12 lidhur me nenin 370 të KPPK-së, meqë në aktgjykimet e kundërshtuara, nuk janë paraqitur faktet në mënyrë të qartë dhe të plotë, se cilat janë ato fakte, për të cilat këto gjykata kanë konsideruar si të vërtetuara, kur i dënuari është shpallur fajtor dhe gjykuar dhe se në aktgjykimet e kundërshtuara nuk është vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse.

Në kërkesë më tutje, theksohet se edhe pse mbrojtja në ankesën e paraqitur ka konstatuar se nuk është vërtetuar pika e akuzës përkitazi me të dënuarin “... pas një mosmarrëveshje në mes

të pandehurit dhe të ndjerit, lidhur me bllokimin e rrugës, të njëjtit fillojnë të rrihen...” e pastaj shkojnë të miturit B. dhe D.L. edhe pse është vërtetuar se kjo mosmarrëveshje dhe rrahje, ka filluar në mes të dëshmitarit V., e në ato momente kishte arritur i dënuari B., i cili nuk kishte pasur asgjë në duar, e që i njëjti menjëherë i ishte bashkangjitur përlëshjes..”. E theksuar si më lartë siç thuhet në kërkesë, jep me kuptuar se i dënuari B. edhe pse ditën kritike ka pasur të bllokuar rrugën për të shkuar në shtëpi të tij, nuk ka ndërruar asnjë fjalë me tani të ndjerin I.L. Ndërsa më vonë në vendin e ngjarjes shkon dëshmitari D.L., për ta marrë automatikisht dhe tek atëherë fillon përlëshja mes D. dhe I., ndërsa i dënuari B.L., në vendin e ngjarjes arrin, pasi që dëgjon zhurmën që ishte krijuar atje mes të D.L. dhe tani të ndjerit I.L.

Mbrojtja në kërkesë gjithashtu konsideron, se me aktgjykimin e kundërshtuar është shkelur në dëm të dënuarit ligji penal, për faktin se provat dhe faktet e administruara gjatë shqyrtimeve të mbajtura gjyqësore, padyshim vërtetojnë faktin se i dënuari, ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij, ose thjesht për t'i ndarë pjesëmarrësit tjerë në rrahje, e në rastin konkret sipas dispozitës së nenit 190 par. 3 të KPK-së, personi nuk është penalisht përgjegjës sipas nenit 190 par.1 të KPK-së, “nëse ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij, për të mbrojtur veten apo për t'i ndarë pjesëmarrësit e tjerë në rrahje”, ashtu që pretendohet se në veprimet e të dënuarit nuk janë përmbushur elementet e veprës penale në fjalë.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë të gjitha faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për secilin fakt janë paraqitur të dhëna të arsyetuara në secilën pikë të aktgjyimit dhe janë dhënë arsye duke vlerësuar faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, vlerëson secilën provë të

administruar e sidomos faktet kundërthënës të cilat i paraqet e sidomos dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar dhe atë dëshmitarët V.S., H.L., D.L., B.L. dhe A.L., të cilët dëshmitar kanë paraqitur dëshmitë e tyre varësisht prej raporteve familjare mes tyre, pasi siç ka konstatuar në arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, dëshmitë e dëshmitarëve i ka vlerësuar në mënyrë të kujdesshme, për shkak të faktit se dëshmitarët H.L., D.L., B.L., janë bashkëshortja përkatësisht djemtë e të dënuarit B.L., kurse A.L. është bashkëshortja e të ndjerit I.L.

Pretendimi i paraqitur në kërkesë, se i dënuari nuk ka kryer veprën penale pjesëmarrja në rrahje dhe se ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij, ose për t'i ndarë pjesëmarrësit tjerë në rrahje, po ashtu nuk është i qëndrueshëm. Sipas arsyetimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk qëndrojnë argumentet e mbrojtjes pasi që është vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë përmbushur elementet objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale pjesëmarrja në rrahje siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 190 par.1 të KPRK-së dhe e cila në mënyrë shprehimore ka përcaktuar se “ *kushdo që merr pjesë në rrahje, e cila rezulton me vdekje ose lëndim të rëndë trupor të personit, për pjesëmarrje në rrahje, dënohet me gjobë ose burgim deri në tri (3) vjet* ”. Arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, pjesëmarrjen aktive të të dënuarit në rrahje e vërteton posaçërisht përmes dëshmisë së dëshmitarit V.S., që me të drejtë vlerësohet se është dëshmitari më objektiv në këtë rast meqë nuk është familjar me asnjërën palë dhe i cili thekson se: “ *... gjatë përleshjes që kanë qenë duke e bërë D. me I. në ato momente ka ardhur edhe i akuzuari B., i cili nuk kishte pasur asgjë në dorë dhe deri sa kanë qenë duke u rrahur mes vete D. dhe I. dhe menjëherë edhe i akuzuari B. kishte filluar përleshjen ku B. dhe I., janë kapur për qafe duke u përleshur dhe kanë filluar të goditen me grushte mes vete ...*”, e që përmes këtij përshkrimi të arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë, konstatohet se i dënuari kishte marrë pjesë aktivisht në rrahje pikërisht me të ndjerin deri sa tani i ndjeri dhe djali i të dënuarit ishin duke u përleshur mes veti. Andaj nuk qëndrojnë pretendimet, se i dënuari ka marrë pjesë në rrahje pa fajin e tij, pasi që kyçet në rrahje në momentin kur ishin duke u rrahur djali i tij D.L. dhe i ndjeri I.L., e që i dënuari nuk ishte duke e mbrojtur veten apo nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim për ti ndarë pjesëmarrësit në rrahje dhe as që kishte qëllim ndarjen e tyre.

Në rastin konkret me të drejtë gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e saj ka konstatuar se “ *...në këtë përleshje kanë marrë pjesë së paku tre persona dhe atë i akuzuari B.L., djali i tij Dardani dhe tani i ndjeri I.L., dhe se në rastin konkret është plotësuar kushti objektiv i*

ndëshkimit pasi që në këtë ngjarje është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit I.L., dhe se i akuzuari B.L. ka marrë pjesë në mënyrë fizike dhe aktive duke e u kacafytur fillimisht e pastaj edhe duke e goditur tani ndjerin I.L....”, e me këtë është e qartë për faktin se edhe paraprakisht i dënuari ishte në dijeni se tani i ndjeri ishte në vendin e ngjarjes dhe pasi që shkoi në shtëpinë e tij menjëherë u kthye në vendin ku edhe u zhvilluara rrahja përkatësisht vrasja e të ndjerit I.L.. I dënuari fillimisht nuk ishte fare në vendin e ngjarjes por shkoi aty pasi që dëgjoi zhurmën e rrahjes, nuk kishte qëllim të ndaj pjesëmarrësit në rrahje pasi as një veprim nuk e ndërmori në këtë drejtim dhe nuk e mbrojti veten pasi që tani i ndjeri ishte duke u ballafaquar fillimisht me djalin e të dënuarit e pastaj edhe me të dënuarin, të cilat janë konstatuar në arsyetimin e aktgjykimit të saj gjykata e shkallës së parë.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përshkrimin e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.6/2018, më datë 11.02.2018

Bashkëpunëtorja profesionale,
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta